

17.10.2017

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA NOVOBËRDË, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, përmes gjyqtarit të vetëm Hasan Sadiku, në çështjen penale kundër të akuzuarit, L. H., nga Gjilanit, për shkak të veprës penale, Posedimi I paautorizuar I narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 paragrafi 1 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore, Departamenti për krime të përgjithshme në Gjilan (PTH), PP.II.nr. 254/2017 e dates 09.02.2017 dhe kërkesës së PTH në Gjilan për dhënien e urdhërit ndëshkimor, më 12.06.2017, hartoi këtë.

AKT GJYKIM

PRANOHET kërkesa e PTH në Gjilan, PP.II.nr. 254/2017 e dat. 09.02.2017 për dhënien e urdhërit ndëshkimor ndaj të akuzuarit,

L. H. nga babai dhe nëna i lindur më , në Gjilan, me vendbanim në lagjen " " nr.10/1 në Gjilan, din shkrim lexim, ka të kryer shkollën e mesme, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr, tel. 045-538-136.

E shtë fajtor

Sepse më datën 05.02.2017, rreth orës 00.05minuta, në fsh., Komuna e Novobërdës, tek i akuzuari L. H., i është gjetur në posedim substanca narkotike, në atë mënyrë që gjatë një kontrole rutinore që i është bërë nga ana e policisë në oborrin e Kolegjit " " në automjetin e markës " " me targa të regj. " " e parkuar në oborrin e kolegjit " " ku si shofer ishte E. Sh., i akuzuari L. H. dhe pasagjerja G. A., dhe gjatë kontrollimit të bërë, pa sulëses së parë të pasagjerit është gjetur një qese me substancë narkotike e llojit Maurihanë, ndërsa gjatë kontrollimit më detal në mbrendi të eutomjetit është gjetur edhe një qese e narkotikut poashtu e llijit Maurihanë, pronë e të akuzuarit L. H. me që raste nga njësitë i policisë së DHNT saia e narkotikut të gjetur te i akuzuari sekuestrohet, ku pas matjes dhe kryerjes së testit fushor ka rezultuar se sasia e narkotikut të llojit Maurihanë ka qenë 1.2 gram. dhe në këtë mënyrë është vërtetuar se me veprimet e veta pa leje dhe autorizim ka poseduar substancën e rrezikshme narkotike.

Me çka ka kryer vepër penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së,

Andaj gjykata bazuar në dispozitën e sipërtheksuar ligjor, si dhe neneve 4, 41, 46, 73,75, 85 dhe 86 e ne lidhje me nenin 365 dhe 495 të KPPK-së, të akuzuarin e

GJYKON

Me dënim me gjobë në shumën prej 200 € (dyqindë) Euro, të cilën shumë i akuzuari, do ta paguarj në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nëse i akuzuari refuzon që ta arkëtoj dënimin me gjobë ose nuk është në gjendje ta arkëtoj atë, atëherë dënimin me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, në atë mënyrë që për çdo 20 €, të dënimin me gjobë do të caktohet nga një ditë burgim.

Obligohet i akuzuari që ta arkëtoj paushallin gjyqësor, në shumë prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë.

Nga i akuzuari konfiskohet sasia e narkotikut e llojit Maurihanë në sasi prej 1.2 gram.

Arsyetim

PTH-Departamenti për Krime të përgjithshme në Gjilan, ka ngritur aktakuzë, PP.II, nr. 254/2017 e dat. 09.02.2017, kundër të pandehurit L. H. nga Gjilani, për shkak të veprës Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose analoge nga neni 275 parag. 2 lidhur me parag. 1 të KPRK-së,

PTH, pastaj, ka paraqitur kërkesën, PP.II.nr. 251/16 e dat. 00.02.2017, për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe ka kërkuar që të akuzuarit t'i shqiptohet dënim me gjobë, pa e mbajtur shqyrtimin gjyqësor me arsyetimin se janë plotësuar kushtet ligjore për një gjë të tillë, sipas nenit 493 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Gjykata, pasi shqyrtoi, aktakuzën e PTH në Gjilan me kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoi se duhet të pranohet kërkesa e PTH për dhënien e urdhrin ndëshkimor ndaj të akuzuarit, dhe të njëjtit t'i shqiptohet dënimi me gjobë.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura: aktakuza, kërkesa për dhënjen e urdhrin ndëshkimor dënim me gjobë, raporti fillestar i incidentit me nr. 2017-DHTN-71 i datës 01.02.2017, deklarata e të pandehurit, vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të narkotikëve, i datës 05.02.2017, Raporti i shpejtë i datës 05.02.2017, ofrojnë bazë të mjaftueshme për dhënien e urdhrin ndëshkimor me bindje se edhe ky dënim i shqiptuar do të ndikojë pozitivisht te i pandehuri dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 41 të KPPRK-së, prandaj e miratoi kërkesën e PTH nga Gjilani, dhe të pandehurin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor dënimit me gjobë në shumën prej 200 € (dyqinde) euro.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor është marrë në bazë të nenit 453 paragrafi 1 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shqiptimin e dënimit plotësues është i bazuar në dispozitën e nenit 62 të KPPK-së.

Konform nenit 463 paragrafi 1 dhe 2 të KPPRK-së, të dëmtuarit B. K. nga fshati Komuna e Gjilanit dhe G. H. nga Gjilani, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohen në kontest civil.

Nga të cekurat si më lartë dhe në bazë të nenit 495 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN-DEGA NOVOBËRDË - DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM

P.nr. 17/2017, më 12.06.2017



Gjyqtari,
Hasan Sadiku

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi- urdhrin ndëshkimor mund të ushtrohet kundërshtim në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimt të të njëjtit. Kundërshtimi i dorëzohet kësaj gjykate.

